

Dyshohet se në maj i vuri flakën një veture në Prishtinë, arrestohet



Foto: Ilustrim

Policia e Kosovës ka njoftuar se ka arrestuar të një të dyshuar për djegien e një veture, që ka ndodhur më 11 maj të këtij vitit në rrugën "Malush Kosova" në Prishtinë.

Ai dyshohet për veprat penale zjarrvënje dhe mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armës.

"Rasti ka ndodhur me 11.05.2023, në rrugën 'Malush Kosova' në Prishtinë, me ç'rast në parkingun e një ndërtese ishte djegur një veturë me targë të huaj. Ndërmarrja e veprimeve hetimore dhe veprimeve të tjera operative të kryera nga njësi të hetimeve të përgjithshme, ka rezultuar me identifikimin si dhe arrestimin e të dyshuarit; Rr. A. 26-vjeçar, mashkull, shtetas i republikës së Kosovës, për të cilët dyshohet me bazë të jetë përfshirë në rastin në fjalë", thuhet në njoftimin e Policisë.

Gjatë kontrollit tek i dyshuari thuhet se janë gjetur një revole të tipit CZ, e kalibri 7.65mm, si dhe gjashtë copë fishekë të kalibrit 7.65mm.

"I dyshuari, pas arrestimit, me aktvendim mbi ndalimin e personit të dyshuar, të nxjerrë nga ana e prokurorit të shtetit u dërgua në qendrën e mbajtjes prej 48 orësh, si vijimësi e fazave të mëtejme të procesit hetimor", thuhet në njoftim.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

#DJEGIA


#VETURA

#ARRESTOHET

#PRISHTINË

10 korrik 2023, 22:48


Shpërndaje në



Qetësoni dhimbjen e kockave dhe të muskujve në kushte shtëpie

Blog | Sponsored

Lexo më shumë



Ja si mund të mbani në kontroll mykun e këmbëve në kushte shtëpie

Blog | Sponsored

Lexo më shumë



Gjendet e vdekur serbja që u raportua e zhdukur të mërkurën në Zveçan

Është gjetur e vdekur gruaja serbe e cila ka qenë e raportuar si person i zhdukur të mërkurën në Zveçan. Viktima është gjetur në lumin Ibër në fshati Vallaq nga ekipet e kërkim-shpëtimi...

Kohanet



Ja disa këshilla në lidhje me dhimbjen e kockave


Blog | Sponsored

Lexo më shumë

TË TJERA



Arrestohet administratori i plazhit ku u mbytën babai me dy djemtë



Bie nga skelet një person në Rahovec



Dy familjarë rrihen mes vete për pronë në Gjakovë



Policia nis hetim për një ngacmim seksual në Skenderaj